

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROGAMEVE DHE OFRUESVE TË AFP
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE NË AFP

UDHËZUES

**Për procedurat, afatet kohore dhe përgjegjësitë që lidhen me kualifikimin e
mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2024.**

Datë 26.02.2024

Ky Udhëzues bazohet në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 21, datë 27.06.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional”, i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr 64, datë 20.02.2024. Palët e angazhuara në kualifikimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP (AKAFPK, AKPA, ofruesit e AFP, mësimdhënësit e kulturës profesionale) duhet të zbatojnë kërkesat e Udhëzimit Nr. 21, datë 27.06.2022, i ndryshuar, si dhe afatet kohore përkatëse, sikurse tregohen edhe në këtë Udhëzues.

Udhëzuesi “Për procedurat, afatet kohore dhe përgjegjësitë që lidhen me kualifikimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2024” i datë 09.01.2024 *shfuqizohet*.

Ky Udhëzues, Udhëzimi Nr. 21, datë 27.06.2022, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr 64, datë 20.02.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 21, datë 27.06.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional”, janë të publikuara në faqen e internetit të AKAFPK në linkun <https://www.akafp.gov.al/kualifikimi-i-mesimdhenesve/>

**Tabela e procedurave, afateve kohore dhe përgjegjësiive që lidhen me kualifikimin e
mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2024.**

Nr	Procedurat për kualifikimin - 2024	Afatet kohore	Përgjegjësitë
1	Procedura për fitimin e kategorive të kualifikimit (atestimit) nga mësimdhënësit e kulturës profesionale për vitin 2024, kryhet në periudhën:	1 janar – 15 korrik 2024	AKAFPK, AKPA, ofruesit e AFP, mësimdhënësit e AFP
2	Njoftimi (me e-mail) nga AKAFPK i kandidatëve për	Deri në 09 janar	AKAFPK

	fillimin e procedurës, hapat që duhet të ndjekin dhe adresën ku duhet të dërgojnë dokumentet.	2024	
	<i>Portofoli (dosja) i kualifikimit</i>		
3	Krijimi i Komisionit për Kualifikimin e Mësimdhënësve të AFP (KKM), me Urdhër të brendshëm të AKAFPK.	Deri në 09 janar 2024	AKAFPK
4	Përgatitja, plotësimi dhe dërgimi, nga mësimdhënësit, i portofolit me dokumentacionin e kërkuar për kualifikimin, përfshirë edhe trajnimet e akredituara.	Deri në 15 mars 2024	Mësimdhënësit, kandidatë për kualifikimin
5	Shqyrtimi dhe skedimi i portofoleve të kandidatëve nga Komisioni i kualifikimit të mësimdhënësve të AFP (KKM) dhe informimi individual (me e-mail) i kandidatëve mbi portofolet, nëse janë të plota apo është nevoja për plotësime të mundshme.	18 - 29 mars 2024	KKM-AKAFPK
6	Plotësimi dhe dërgimi i dokumentacionit të munguar nga kandidatët.	02 – 08 prill 2024	Mësimdhënësit kandidatë për kualifikimin
7	Vlerësimi i portofolit të çdo kandidati dhe njoftimi i tyre për pikët e fituara dhe protokollimi i rezultatit.	09 – 23 prill 2024	KKM-AKAFPK
8	Pranimi i ankimimeve të mundshme të kandidatëve mbi rezultatit e vlerësimit të portofolit.	24 -26 prill 2024	KKM-AKAFPK
9	Shqyrtimi i ankesave dhe njoftimi individuali i kandidatëve, me e-mail, mbi rezultatit përfundimtar të vlerësimit të portofolit.	29 prill – 07 maj 2024	KKM-AKAFPK
10	Protokollimi i vlerësimeve përfundimtare të portofoleve dhe njoftimi i kandidatëve.	07 maj 2024	KKM-AKAFPK
	<i>Provimet e kualifikimit</i>		
11	Publikimi në faqen e Agjencisë, i njoftimit për Provimet (listat, datat, orët, kohëzgjatjet, vendin etj.).	08 maj 2024	AKAFPK
12	Realizimi (administrimi) i provimeve të mësimdhënësve, të ndarë në grupe deri 15 persona.	25 maj 2024	AKAFPK
13	Vlerësimi i testeve të plotësuara nga kandidatët dhe protokollimi i rezultateve të vlerësimit.	27 – 29 maj 2024	KKM
14	Njoftimi individualisht me e-mail i pjesëmarrësve për rezultatet e testeve.	30 maj 2024	AKAFPK
15	Pranimi i ankimimeve nga pjesëmarrësit, mbi rezultatit e vlerësimit të testeve.	31 maj - 04 qershor 2024	AKAFPK
16	Shqyrtimi i ankesave të mundshme dhe njoftimi për rezultatet përfundimtare të vlerësimit të testit.	05 – 11 qershor 2024	KKM
	<i>Demonstrimi i seancës mësimore e hapur</i>		
17	Periudha e realizimit të seancave mësimore të hapura	08–31 maj	AKAFPK

		2024	
18	Njoftimi (me e-mail) i kandidatëve për periudhën e realizimit të seancave mësimore të hapura për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”.	02 Prill 2024	AKAFPK
19	Njoftimi me e-mail i drejtuesve të shkollave dhe koordinatorëve të ZHVP-së për periudhën në të cilën do të realizohen seancat mësimore të hapura	02 Prill 2024	AKAFPK
20	Propozimi i datave të mundshme nga kandidatët për realizimin e seancës mësimore të hapur nga ana e tyre.	9 Prill 2024	Mësimdhënësit kandidat për kualifikim për kategorinë “Mësues mjeshtër”
21	Hartimi i kalendarit përfundimtar të realizimit të seancave mësimore të hapura dhe njoftimi me e-mail i kandidatëve.	16 Prill 2024	AKAFPK
22	Realizimi i seancave të hapura mësimore	08 -31 maj 2024	Mësimdhënësit kandidat për kualifikim për kategorinë “Mësues mjeshtër”
23	Komunikimi i rezultatit të vlerësimit të seancës mësimore të hapur të realizuar nga kandidati.	brenda 2 ditëve punë nga dita e realizimit të seancës mësimore).	AKAFPK
24	Pranimi i ankesave nga kandidatët për kategorinë “Mësues mjeshtër” mbi rezultatin e vlerësimit të seancës mësimore.	brenda 3 ditëve punë nga marrja e njoftimit	KKM
25	Shqyrtimi i ankesave të mundshme dhe njoftimi i kandidatit për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të seancës mësimore.	brenda 3 ditëve punë nga marrja e njoftimit	KKM
26	Njoftimi me e-mail i rezultatit përfundimtar të vlerësimit të seancës mësimore, pas ankimimit dhe mbajtja procesverbalit përkatës.		KKM
	<i>Vlerësimi përfundimtar dhe Certifikimi</i>		
27	Llogaritja e pikëve përfundimtare të kandidatëve dhe protokollimi i rezultatit të kualifikimit.	12 - 14 qershor 2024	KKM
28	Njoftimi me e-mail i kandidatëve për rezultatin e kualifikimit.	14 qershor 2024	AKAFPK
29	Pranimi i ankimimeve nga kandidatët, mbi rezultatin e vlerësimit të kualifikimit.	18 – 20 qershor 2024	AKAFPK
30	Shqyrtimi i ankesave dhe njoftimi për rezultatet përfundimtare të kualifikimit për kategorinë përkatëse dhe	21 – 27 qershor 2024	KKM - AKAFPK

	protokollimi i tyre.		
31	Dërgimi në AKPA i listës emërore të kandidatëve me rezultatet e arritura dhe shkallët e fituara.	28 qershor 2024	AKAFPK
32	Përgatitja, printimi dhe plotësimi i certifikatave të kandidatëve që kanë kryer me sukses gjithë procedurën e kualifikimit për kategorinë përkatëse.	01 - 05 korrik 2024	AKAFPK
33	Dërgimi me postë i certifikatave të mësimdhënësve në adresat e ofruesve të AFP – ve ku kandidatët janë të punësuar.	Deri më 08 korrik 2024	AKAFPK
34	Plotësimi i regjistrit të certifikatave të kualifikimit në bankën e të dhënave të AKAFPK dhe mbyllja e procedurës së kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale të AFP, për vitin 2024.	Deri më 15 korrik 2024	AKAFPK